

Titulli: Menaxhimi i qëndrueshëm i korridoreve ekologjike në zonën e Polis-Valamarë-Rungaje-Moravë-Gramoz.

Ky projekt adreson rëndësinë e vazhdimësisë ekologjike midis zonave me rëndësi për biodiversitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit si një domosdoshmëri për të siguruar proceset dhe konservimin natyror edhe jashtë zonave që aktualisht kanë status zonë e mbrojtur. Objektivat kryesor të këtij projekti konsistojnë në rritjen e angazhimit të aktorëve lokalë drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të korridoreve ekologjike si dhe informimin dhe sensibilizimin e komunitetit, përdoruesëve apo menaxherëve të zonës mbi rëndësinë e korridoreve ekologjike në funksion të konservimit natyror.

Ky projekt përfshin

- 5 zona të mbrojtura: Parku Kombëtar Shebenik, Parku Natyror Stravaj-Sopot, Peizazhi i mbrojtur Liqeni i Pogradeci, Peizazhi i mbrojtur Guri i Nikës dhe Parku Natyror Mali i Tomorrit.
- Pjesërisht territorin e 6 bashkive: Librazhd, Prrenjas, Pogradec, Gramsh, Maliq, Skrapar
- Pjesërisht territorin e 3 qarqeve: Qarku Elbasan, Korce dhe Berat

Projekti zbatohet nga [EcoAlbania](#) me financim të [PONT](#)

Kohëzgjatja: 36 muaj

Data e fillimit: 1 shkurt, 2023

Pse korridori ekologjik Polis-Valamarë-Rungaje-Moravë-Gramoz është i rëndësishëm?

Ky korridor malor gjendet në pjesën jug-perëndimore të Shqipërisë, i cili kufizohet në jug me malin e Gramozit në kufi me Greqinë (Fig. 1). Ky korridor është i rëndësishëm për krijimin e popullatave të qëndrueshme të gjitarëve duke lidhur malet e Pindos në Greqi me sistemin malor qëndror në vend. Vargmali Valamarë-Polis është zona e dytë në Shqipëri ku është konfirmuar riprodhimi i rrëqebullit ballkanik, ku një familje rrëqebulli me tre individë është fotografuar nga kamerat kurth. Në vitin 2020, prania dhe riprodhimi i tre mishngrënësve të mëdhenj (ariu, ujku dhe rrëqebulli i Ballkanit) u vërtetua me kamera në zonën e ekosistemit Polis-Gur i Zi-Valamara.

Pse ka qënë nevoja e projektit në këtë zonë?

Pavarësisht vlerave natyrore, funksionaliteti i kësaj zone si korridor ekologjik kërcënohet nga fragmentizimi i habitatit për shkak të prerjeve, zjarreve, urbanizimit dhe përdorimit dhe menaxhimit të papërshtatshëm të burimeve natyrore. Kjo e fundit shpesh lidhet me kapacitetet financiare/teknike/njerëzore të kufizuara, strukturat e planifikimit dhe menaxhimit jo gjithmonë efektive, mungesa e të dhënave dhe studimeve të disponueshme për vlerat natyrore, zbatimin e dobët të ligjit në fushën e ruajtjes së natyrës dhe standardeve mjedisore.

Nga ana tjetër konektiviteti ekologjik nuk ka kufijë, që do të thotë përpjekjet e konservimit natyror dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territorit përtej kufirit të zonave të mbrojtura është një domosdoshmëri për të siguruar një funksionalitet të këtij korridori si një e tërë. Më shumë iniciativa dhe mbështetje strategjike për një menaxhim më të gjerë përtej zonave të mbrojtura dhe një përfshirje më sistematike e sektorëve të tjerë kyç, si bujqësia, zhvillimi urban dhe planifikimi është prioritet.

Çfarë është planifikuar të zbatohet në kuadër të projektit?

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të ruajë dhe përmirësojë konektivitetin ekologjik të korridorit Polis - Valamare - Rungaje - Morave - Gramoz (CCA) përmes një qasjeje të qëndrueshme dhe pjesëmarrëse të qeverisjes. Projekti ka dy objektiva specifike:

1: Rritja e angazhimit të palëve të interesuara drejt një qasjeje të qëndrueshme dhe me pjesëmarrje në menaxhimin e CCA.

Si do të arrihet kjo?

Në projekt janë planifikuara takime në 6 bashkitë dhe AdZM-të të cilat menaxhojnë këtë territor me qëllim prezantimin e projektit dhe koordinimin për krijimin e një partneriteti i cili do të mundësojë një zhvillim sa më të qëndrueshëm të korridorit ekologjik. Gjatë zbatimit të projektit është planifikuar një analizë dhe hartëzim i aktorëve të përfshirë; vlerësim i situatës aktuale lidhur me zhvillimin rural, planifikimin dhe menaxhimin territorial si dhe një analizë e aspekteve socio-ekonomike të zonës me fokus potencialin ekoturistik dhe agroturizëm. Gjetjet nga këto studime do të informojnë aktivitetet menaxhuese pjesë e një plani veprimi i cili do të udhëzojë dhe orientojë njësitë vendore drejt zhvillimit të qëndrueshëm të territorit. Gjithashtu këto vlerësime do të ofrojnë bazën e informacionit për aktivitetet informuese dhe sesionet e trajnimeve.

2: Rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë civile dhe palëve të interesuara për rëndësinë e qeverisjes dhe menaxhimit të korridoreve ekologjike.

Si do të arrihet kjo?

Gjatë zbatimit të projektit janë planifikuar: zhvillimi i një vizite studimore në zona të mbrojtura të cilat kanë demonstruar sukses në përfshirjen e komunitetit në menaxhim, aktivitete edukuese, fushatë sensibilizuese në media për promovimin e vlerave natyrore dhe vizionin e zhvillimit të korridorit ekologjik, sesione informuese dhe trajnime.

Kush janë aktorët dhe përfituesit kryesorë të këtij projekti?

- Bashkitë/Njësitë administrative
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)/Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura
- Komitetet e menaxhimit të Zonave të Mbrojtura
- Komuniteti lokal
- Operatorët turistikë/ bujtina
- OJQ-të.






Figure 1. Korridori ekologjik Polis - Valamare - Rungaje - Morave - Gramoz